

# Bilanci i energjisë elektrike

## Viti 2022


**Tiranë, më 2 Mars 2023:** Gjatë vitit 2022, energjia elektrike në dispozicion u ul me 5,8 %.

**Prodhimi neto vendas** i energjisë elektrike arriti vlerën 7.003 GWh nga 8.963 GWh energji të prodhuar në vitin 2021, duke shënuar një rënie të prodhimit me 21,9 %.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 55,1 %, nga hidrocentralet private dhe koncensionare në masën 44,2 % dhe nga të tjerë prodhues (Fotovoltaikë) në masën 0,7 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje) arriti vlerën 3.044 GWh nga 2.253 GWh që ishte një vit më parë, duke shënuar kështu një rritje me 35,1 %. Eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti vlerën 2.123 GWh nga 2.800 GWh duke shënuar një rënie me 24,2 % (tab.1).

**Fig. 1 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto**



**Për publikim 02/03/2023**

**Tab. 1 Bilanci i energjisë elektrike, vjetorë**

MWh

Treguesit		2021	2022
<b>A</b>	<b>Energji në dispozicion (A=1+2-3)</b>	<b>8.414.808</b>	<b>7.923.653</b>
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	8.962.703	7.002.647
1.1	Termocentrale	0	0
1.2	Hydrocentrale (1.2=a+b)	8.921.947	6.951.387
a	Publike (a=a.1-a.2)	5.343.974	3.858.562
a.1	Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	5.392.709	3.895.093
a.2	Humbje dhe konsum vetjak	48.735	36.531
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	3.577.973	3.092.825
1.3	Të tjerë prodhues (Fotovoltaik)	40.756	51.260
2	Importi bruto (energji në marrje)	2.252.548	3.043.533
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	2.800.443	2.122.527
<b>B</b>	<b>Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)</b>	<b>8.414.808</b>	<b>7.923.653</b>
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	1.784.871	1.657.835
1.1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	227.918	199.994
1.2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) <sup>1</sup>	1.556.953	1.457.840
a	Humbjet teknike në shpërndarje	1.028.670	980.012
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje <sup>2</sup>	528.283	477.828
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	6.629.937	6.265.818
2.1	Familjarë	3.089.500	3.074.801
2.2	Jo Familjarë	3.540.437	3.191.018


<sup>1</sup> Detajimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

<sup>2</sup> Humbjet jo- teknike përbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

**Hidrocentralet publike**, në vitin 2022, prodhuan 3.859 GWh nga 5.344 GWh të prodhuar në vitin 2021, duke shënuar kështu një rënie të prodhimit me 27,8 %. **Hidrocentralet private dhe koncensionare**, prodhuan 3.093 GWh nga 3.578 GWh të prodhuar një vit më parë, duke shënuar një rënie të prodhimit të energjisë elektrike me 13,6 %.

**Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca mes eksportit dhe importit bruto të energjisë)**, në vitin 2022, ka arritur vlerën negative prej 921 GWh krahasuar me vitin 2021 ku kishte një vlerë pozitive prej 548 GWh (fig.2).


**Fig. 2 Shkëmbimi i energjisë elektrike**



**Humbjet në rrjet** kanë arritur vlerën 1.658 GWh nga 1.785 GWh duke shënuar kështu një rënie me 7,1 %. **Humbjet në transmetim** janë ulur me 12,3 % dhe pesha që zënë në totalin e humbjeve në rrjet është 12,1 %.

**Humbjet në shpërndarje** zënë një peshë më të madhe, rreth 87,9 % të humbjeve në rrjet dhe janë ulur me 6,4 %, krahasuar me vitin 2021 (fig.3).


**Fig. 3 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët**



**Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët**, në vitin 2022, arriti vlerën 6.266 GWh nga 6.630 GWh që ishte në vitin 2021.


**Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë** u ul me 0,5 %, duke arritur vlerën 3.075 GWh nga 3.090 GWh që ishte në vitin 2021, ndërsa **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** u ul me 9,9 % duke arritur vlerën 3.191 GWh nga 3.540 GWh që ishte një vit më parë (fig.4).

**Fig. 4 Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët**



Në fig.5 paraqitet **struktura në përqindje e prodhimit neto vendas sipas tremujorëve** për periudhën 2018-2022. Në vitin 2022 kemi një rritje të prodhimit neto në tremujorin e tretë dhe të katërt dhe një rënie të prodhimit neto në tremujorin e parë dhe të dytë, krahasuar me vitin 2021.

**Fig. 5 Struktura në përqindje e prodhimit neto vendas sipas tremujorëve, 2018-2022 (%)**



### Tremujori IV 2022

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, **energja elektrike në dispozicion** u ul me 14,2 %.

**Prodhimi neto vendas** i energjisë elektrike arriti vlerën 1.969 GWh nga 1.588 GWh energji të prodhuar në tremujorin e katërt të vitit 2021, duke shënuar një rritje të prodhimit me 24,0 % (tab.2).

**Tab. 2 Bilanci i energjisë elektrike, tremujori IV**

MWh


Treguesit		Tr. IV 2021	Tr. IV 2022
<b>A</b>	<b>Energji në dispozicion (A=1+2-3)</b>	<b>2.131.434</b>	<b>1.827.840</b>
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	1.587.703	1.969.222
1.1	Termocentrale	0	0
1.2	Hidrocentrale (1.2=a+b)	1.581.253	1.961.031
a	Publike (a=a.1-a.2)	850.283	1.136.817
a.1	Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	858.838	1.147.274
a.2	Humbje dhe konsum vetjak	8.555	10.457
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	730.970	824.214
1.3	Të tjerë prodhues (Fotovoltaik)	6.450	8.191
2	Importi bruto (energji në marrje)	950.218	522.701
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	406.487	664.084
<b>B</b>	<b>Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)</b>	<b>2.131.434</b>	<b>1.827.840</b>
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	424.235	384.646
1.1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	48.299	49.865
1.2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) <sup>1</sup>	375.936	334.781
a	Humbjet teknike në shpërndarje	253.106	217.538
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje <sup>2</sup>	122.830	117.242
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1.707.199	1.443.194
2.1	Familjarë	803.153	728.867
2.2	Jo Familjarë	904.046	714.328

<sup>1</sup> Detajimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

<sup>2</sup> Humbjet jo- teknike përbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, importet bruto të energjisë elektrike (energji në marrje) u ulën me 45,0 % dhe eksportet bruto të energjisë elektrike (energji në dhënie) u rritën me 63,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (fig.6).


**Fig. 6 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto**



Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, **humbjet në transmetim** janë rritur me 3,2 %, ndërsa **humbjet në shpërndarje** kanë rënë me 10,9 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

**Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët** u ul me 15,5 %. **Përdorimi nga konsumatorët familjarë** u ul me 9,2 %, ndërsa **përdorimi nga konsumatorët jo familjarë** u ul me 21,0 % (fig.7).

**Fig. 7 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët**



# Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për një periudhë tremujore nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:

- KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSSH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
  - furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
  - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
  - tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

## Përkufizimet e treguesve bazë

**Energji në dispozicion** i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

**Prodhimi neto vendas** llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

**Energji termo** i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

**Energji hidro** i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.



**Humbjet dhe konsumi vetjak** i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

**Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë** u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe liqensohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSSH-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.

**Prodhues të tjerë** i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo.

**Shkëmbimi i energjisë elektrike** i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

**Konsumi i energjisë elektrike** i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

**Humbjet në rrjet** përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. *Humbjet teknike* në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSSH sh.a. *Humbjet jo teknike* i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

**Përdorimi nga konsumatorët** është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë.

**Familjarët** i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihet edhe *dëmi ekonomik* i llogaritur për konsumatorët familjarë.

**Jo familjarët** i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përfshirë konsumin nga familjarët.

Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihet edhe *dëmi ekonomik* i llogaritur për konsumatorët jo familjarë.